





# TRANSPAROMETRI KOMUNAL

PRIZREN, SUHAREKË, RAHOVEC,  
MALISHEVË, DRAGASH, MAMUSHË  
KORRIK – DHJETOR 2016

SHKURT 2017, PRIZREN

COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Përgaditur nga: Naim Cahanaj

Me asistencë hulumtuese nga: Arben Hoxha dhe Ellza Alija

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e The Olof Palme Center. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>7</b>
<b>RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE .....</b>	<b>7</b>
<b>PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE.....</b>	<b>8</b>
<b>RENDITJA EKOMUNAVE .....</b>	<b>8</b>
<b>STATISTIKAT KRAHASUESE 2016 .....</b>	<b>11</b>
<b>TRANSPARENCA NË KOMUNË.....</b>	<b>15</b>
<b>TRANSPARENCA NË RAHOVEC.....</b>	<b>16</b>
<b>TRANSPARENCA NË MALISHEVË .....</b>	<b>18</b>
<b>TRANSPARENCA NË PRIZREN.....</b>	<b>20</b>
<b>TRANSPARENCA NË SUHAREKË .....</b>	<b>22</b>
<b>TRANSPARENCA NË DRAGASH .....</b>	<b>24</b>
<b>TRANSPARENCA NË MAMUSHË .....</b>	<b>26</b>
<b>REKOMANDIMET .....</b>	<b>28</b>
<b>ANEKSET. INDIKATORËT DHE KOMENTET .....</b>	<b>31</b>

# HYRJJE

Transparenca dhe hapja e një institucioni ndaj publikut është tregues thelbësor për mënyrën e qeverisjes së atij institucioni nga udhëheqësit, të zgjedhurit. Në një sistem të shëndoshë demokratik, secili institucion publik qoftë lokal apo qendror duhet të jetë transparent dhe i hapur, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar dhe të kenë mundësi të marrin pjesë aktive në proceset e vendim-marrjes. Në kuptimin e ngushtë të fjalës, një institucion konsiderohet i hapur, kur para së gjithash qytetarëve u mundësohet që të jenë të pranishëm, madje edhe fizikisht dhe të përcjellin nga afër punimet e tij.

Rëndësia e transparencës shtohet edhe më tutje kur kemi të bëjmë me institucionet lokale. Ato si të tilla janë mekanizmi i parë ku qytetari adreson problemet dhe shqetësimet e tij dhe komunitetit. Rruga, trotuaret, uji, kanalizimet, shkollat, mirëqenia janë problemet jo vetëm që duan zgjidhje nga autoritetet lokale, por edhe alternativat për zgjidhje duhet të nxjerrjen pas një procesi transparent dhe pas një konsultimi të gjerë me qytetarët e asaj komune.

Nëse ndodh e kundërta, kjo mund të qoj në keqpërdorime të pushtetit, niveli i ulët i këtij elementi thelbësor të qeverisjes, transparencës ndaj publikut, shkakton mos informim të duhur të publikut, ngrit mosinteresimin e publikut në punët publike dhe ulë pjesëmarrjen qytetare, një tjetër element i rëndësishëm për qeverisje të mirë.

Në kontekstin e bazës ligjore për transparencë në Komuna, vendi ynë ka një kornizë solide e cila garanton institucione transparente në funksion të qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisjen lokale, ligji për qasjen në dokumente publike janë dokumentet themelore që përcaktojnë transparencën e institucioneve lokale. Normalisht me jo më pak rëndësi janë edhe aktet dhe konventat ndërkombëtare si Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, të cilat Kosova edhe pse ende nuk është palë nënshkruese i ka pranuar si akte të zbatueshme në legjislacionin vendor.

Me qëllim të përmirësimit të këtij procesi KDI ka filluar monitorimin e 6 Komunave të Regjionit të Prizrenit, me theks të veçantë transparencën e tyre karshi publikut. Kjo matje realizohet përmes një indeksi i cili ngërthen në vete 44 indikatorë matës të transparencës komunale. Përmes këtyre indikatorëve provohet të silllet një metodologji të lehtë dhe objektive për matje të transparencës në komuna

dhe gatishmërinë e zyrtarëve lokal për të qenë të hapur ndaj publikut dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrje. Pra, Transparometri përbën në vete një mekanizëm të krahasimit të transparencës së qeverive lokale të udhëhequra nga subjekte të ndryshme politike. Po ashtu, ky indeks krijon mundësinë që të dallohen komunat me performancë më të mirë nga ato me performancë më të dobët në qeverisje dhe të mënjanojë përgjithësimet në vlerësim të komunave që shpesh janë abuzuar nga akterë të ndryshëm.

# METODOLOGJIA

Vlerësimi i Transparometrit ndjek një metodologji të matjes së indikatorëve në mënyrë objektive përgjatë katër shtyllave themelore të qeverisjes lokale. Ky indeks përbëhet nga 44 indikatorë dhe matë transparencën në *Zyrën e Kryetarit/es, Kuvendin e Komunës, Financat Komunale* dhe transparencën në *Konsultime me Publikun* (secila nga katër shtyllat përmban nga 11 indikatorë).

Indikatorët janë përzgjedhur me kujdes duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat nën qeverisjen lokale që përcaktohen me ligjet në fuqi. Indikatorët prekin përgjegjësitë bazike të qeverive lokale, aty ku transparenca duhet të jetë e garantuar, dhe nuk shkon në thellësi të matë transparencën edhe në disa sektorë specifik që janë nën kompetencën e komunës si transparenca në shëndetësi, arsim apo planifikim urban.

## RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE

Rëndësia dhe pesha e indikatorëve është përcaktuar varësisht nga ndikimi që mund të ketë në kontekstin e transparencës së institucioneve komunale.

Kjo rëndësi e indikatorëve është shprehur në numra dhe varion nga 1 deri në 3 (shikoni *Aneksin 1* për indikatorët dhe peshën e tyre). Për secilën nga katër shtyllat, pesha maksimale e 11 indikatorëve së bashku është 35.

Ndërsa vlerësimi i secilit indikatorë është bërë me notën 0 deri në 3 (0 është dhënë aty ku komuna s'ka qenë fare transparente, 3 është dhënë në ata indikatorë ku komunat kanë qenë plotësisht transparente, ndërsa 1 dhe 2 janë dhënë për ata indikatorë ku komuna ka qenë pjesërisht transparente). Nota vlerësuese (0-3) është përpjesëtuar me peshën indikatorit dhe është nxjerrë një vlerësimi i atij indikatorit. Shuma e notave vlerësuese të 11 indikatorëve ka dhënë dhe notën e përgjithshme për komunën në atë shtyllë (Zyre të Kryetarit/es, Kuvend Komunal etj).

Matja e transparencës së indikatorëve është bërë përmes katër mënyrave: ueb-faqes zyrtare të komunës, intervistimit të zyrtarëve komunal (pozitiv dhe opozitiv), monitorimit të takimeve zyrtare të komunave dhe kërkesave për qasje në dokumente publike.

## PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të programit të qeverisjes lokale implementon projektin “Pjesëmarrja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie” projekt ky i cili mbështet nga Olof Palme International Center (OPIC). Projekti i tillë ka për synim monitorimin dhe vlerësimin e Kuvendeve të Komunave të regjionit të Prizrenit me qëllim të ndikimit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga institucionet vetëqeverisëse lokale.

Një nga qëllimet e “Transparometrit” është edhe nxitja e konkurrencës për performancë më të mirë në transparencë. Andaj, në vlerësimin e indeksit që do të shpalojë më poshtë janë të përfshira gjashtë (6) komunat e regjionit të Prizrenit (Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash dhe Mamushë).

## RENDITJA EKOMUNAVE

Nga 44 indikatorët matës që përbëjnë këtë indeks, kryesisht në katër fusha thelbësore të qeverisjes lokale, asnjë komunë nuk del të jetë 100% transparente. Kjo tregon që edhe komunat me performancën më të mirë në qeverisje kanë ende punë për të bërë që të jenë plotësisht transparente, së paku në këto çështje thelbësore të qeverisjes që ky indeks i adreson.

Disa pengesa tek transparenca komunale shkaktohen nga Ministria për Administratë Publike për shkak se ajo është përgjegjëse për platformën dhe menaxhimin e ueb-faqeve të komunave, gjë që kufizon komunat në përpjekje për të bërë dokumente dhe informata lehtë të qasshme për qytetarët e saj. Ueb-faqet e komunave janë të centralizuara dhe nuk lejojnë hapësirë për modernizim dhe përshtatje të ueb-faqeve për qytetarët nga komunat e tyre përkatëse. Duke pasur parasysh përdorimin e internetit në kohët e sotme, ueb-faqet janë tejet të rëndësishme për institucionet publike të bëjnë informatat dhe dokumentet lehtë të qasshme për publikun.

Përgjegjësia më e madhe për hapje të komunës ndaj qytetarëve i mbetet udhëheqësve lokal dhe administratës lokale. Shpërndarja e informatës për planet, planifikimet buxhetore dhe planifikimet e projekteve mbeten sfida që

duhet të adresohen dhe praktikohen nga vetë udhëheqësit komunal. Gjatë punës tone, shumë herë kemi has në mos gatishmëri për të ndarë informatën, herë për shkak të mos vullnetit, herë për shkak të frikës se zyrtarëve të administratës për të ndarë një informatë publike pa dijen e udhëheqësve politik të komunave.

MAPL gjithashtu mund të bëjë shumë më shumë që rregulloret që i lëshon të zbatohen në nivel komunal. Kjo ministri shpesh anashkalon mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve për komuna. Kurse Asociacioni i Komunave mund të bëjmë më shumë në koordinimin e komunave që të adresojnë sfidat me të cilat komunat përballen për të qenë më të hapur ndaj publikut dhe më të qasshëm nga publiku dhe si të ngriten kapacitetet për të qenë më transparent.






Nga 44 indikatorët matës të transparencës që përbëjnë këtë Transparometër (shih metodologjinë për përzgjedhje e indikatorëve dhe Aneksin 1 për indikatorët dhe peshën e tyre në vlerësim) del se disa ngecje në qeverisje komunat i kanë të përbashkëta dhe kurse disa ngecje që qëndrojnë tek një komunë nuk qëndrojnë tek disa të tjera. Të gjeturat e këtij indeksi tregojnë që performanca në transparencë e komunave dallon dhe përderisa disa komuna janë në rrugë të mirë për të arritur transparencë totale në çështje bazike, disa komuna janë hermetikisht të mbyllura ndaj publikut.

SHTYLLA	PIKË TË MUNDSHME	VLERËSIMI PËR KOMUNË					
		Prizren	Suharekë	Rahovec	Malishevë	Dragash	Mamushë
Ekzekutivi	35.0	17.3	19.3	27.0	22.0	15.0	4.3
Kuvend	35.0	23.0	27.3	31.0	26.3	22.7	12.3
Financa	35.0	26.3	28.3	32.3	25.7	25.7	11.3
Konsultime me publikun	35.0	15.3	20.3	21.3	25.3	18.3	13.3
<b>Pikë/Komunë</b>	<b>140</b>	<b>81.9</b>	<b>95.2</b>	<b>111.6</b>	<b>99.3</b>	<b>81.7</b>	<b>41.2</b>
Mesatarja e Pikëve	35	20.5	23.8	27.9	24.8	20.4	10.3
<b>Niveli i Transparencës</b>		<b>58.5 %</b>	<b>68.0 %</b>	<b>79.7 %</b>	<b>70.9 %</b>	<b>58.4 %</b>	<b>29.4 %</b>

Në bazë të gjeturave të këtij indeksi me 44 indikatorë në katër fushat bazike të qeverisjes lokale, të matur për periudhën gjashtë mujore (korrik-dhjetor 2016) del se Komuna e Rahovecit ka qenë komuna me transparente nga gjatë komunat e matura me 79.7 % transparente. Pastaj

radhiten Komuna e Malishevës (70.9 % transparente), Komuna e Prizrenit (58.5 % transparente), Komuna e Suharekës (68.0 % transparente), Komuna e Dragashit (58.4 % transparente) dhe Komuna e Mamushës me (29.4% transparente).

## ✓ NIVELI I TRANSPARENCËS KOMUNALE








- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Zyrës së Kryetarit/es**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Rahovecit (27.0 pikë), Komuna e Malishevës (22.0 pikë), Komuna e Suharekës (19.3 pikë) Komuna e Prizrenit (17.3 pikë), Komuna e Dragashit (15.0 pikë), dhe Komuna e Mamushës (4.3 pikë).
- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Financave Komunale**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Rahovecit (32.3 pikë), Komuna e Suharekës (28.3 pikë), Komuna e Prizrenit (26.3 pikë), Komuna e Dragashit dhe Komuna e Malishevës (me nga 25.7 pikë) dhe Komuna e Mamushës (11.3 pike).
- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Kuvendit të Komunës**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Rahovecit (31.0 pikë), Komuna e Suharekës (me 27.3 pikë) Komuna e Malishevës (me 26.0 pikë), Komuna e Prizrenit (me 23.0 pikë), Komuna e Dragashit me (22.7 pikë) dhe më së paku transparente del të jetë Komuna e Mamushës (12.3 pikë).
- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Konsultimeve me Publikun**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna Malishevës (me 25.3 pikë), Komuna e Rahovecit (21.3 pikë), Komuna e Suharekës (me 20.3 pikë), Komuna e Dragashit (18.3 pikë) Komuna e Prizrenit (15.3 pikë), dhe Komuna e Mamushës (me 13.3 pikë).



# STATISTIKA KRAHASUESE GJATË VITIT 2016

■ Korrik - Dhjetor 2016

■ Janar - Qershor






## KOMUNA E PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit përvec që nuk ka arrit ta përmiresoj indikatorët vlerësues të transparencës në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016, përkundrazi ka shënuar rënie të lehtë nga 20.9 pikë mesatare për katër shtyllat e vlerësimit në 44


indikatoë, ka rënë në 20.5 pikë mesatare. Shtylla e konsultimeve me publikun mbetet si shtyllë e cila ka shënuar rënie më së shumti gjatë periudhës së dytë të vitit 2016, nga 17.7 pikë mesatare ka rënë në 15.3 pikë.



## KOMUNA E SUHAREKËS

Komuna e Suharekës gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016 ka shënuar rritje në pikët mesatare për 4 shtyllat e vlerësimit, nga 19.7 pikë sa ishte në gjashtëmujorin e parë është ngritur në 23.8 pikë mesatare. Komuna e Suharekës vazhdon të jetë më transparente në kategorinë e finan-

cave, ku në dy periudhat vlerësuese ka pikët mesatar më të mëdha në krahasim me tri shtyllat tjera vlerësuese dhe në gjashtëmujorin e dytë ka shënuar një rritje të vogël të pikave mesatare në këtë shtyllë. Ekzekutivi mbetet si shtyllë me pikë më të ulët me 19.3 pikë mesatare.



## KOMUNA E MALISHEVËS

Krahasuar me gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, komuna e Malishevës në gjashtë mujorin e dytë të këtij viti ka shënuar një rritje të ndjeshme të pikave mestare në 4 shtyllat e vlerësimit të majtjes së transparencës. Nga 21.7 pikë mestare që kishte në gjashtë mujorin e parë është ngritur në 24.8 pikë mesatare në gjashtë mujorin e dytë të vitit

2016. Edhe në gjashtë mujorin e dytë, shtylla e kuvendit të komunës mbetet si shtyllë më transparente në komunën e Malishevës me gjithësej 26.3 pikë mesatare derisa rritja më të madhë në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016 ka shënuar në shtyllën e ekzekutivit apo zyrën e kryetarit të komunës.

■ Korrik - Dhjetor 2016  
■ Janar - Qershor

PIKËT MESATARE

24.8

21.7



Kuvendi i Komunës



Ekzekutivi



Financa



Konsultime

## KOMUNA E RAHOVECIT

Komuna e Rahovecit ka shnuar progresin më të maddhë gjatë gjashtë mujorit të dytë krahasuar me gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 duke arritur të akumulojë 27.9 pikë mestare në katër shtyllat e vlerësimit. Përmirësim më të madhë të indikatorëve vlerësues të transparencës kishte

në shtyllën e financave ku nga 35 pikë maksimale ka arritë në 32.3 pikë në këtë shtyllë. Edhe përkundër përmirësimit të indikatorëve vlerësues, komuna e Rahovecit qëndron më dobët në shtyllën e matjes së transparencës tek konsultimet me publikun.

■ Korrik - Dhjetor 2016  
■ Janar - Qershor

PIKËT MESATARE

27.9

24.7



Kuvendi i Komunës



Ekzekutivi



Financa



Konsultime




## KOMUNA E DRAGASHIT

Komuna e Dragashit vazhdon të ketë rritja në përmirësimin e indikatorëve vlerësues të matjes së transparencës bazuar në metodologjin e transprometrit komunal. Nga 18.9 pikë mesatare sa kishtë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, në gjashtë mujorin e dytë është rritur për 20.4 pikë mesatare nga 35 pikët mestare maksimale për katër shtyllat e

vlerësimit. Rritje më të ndjeshme në gjashtë mujorin e dytë kishte tek shtylla e transparencës së Kuvendit të Komunës derisa shtylla e transparencës së financave edhe në gjashtë mujorin e dytë qëndroj pothuajse e njëjtë duke mos arritur të përmbushë vlerësimin e indikatorëve vlerësues në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016.

■ Korrik - Dhjetor 2016  
■ Janar - Qershor

PIKËT MESATARE



Kuvendi i Komunës



Ekzekutivi



Financa



Konsultime

## KOMUNA E MAMUSHËS

Komuna e Mamushës vazhdon të mbetet si komuna me vlerësim më negative Krahasuar me komunitat tjera të rajonit të Prizrenit, ku edhe në gjysmën e dytë të vitit 2016 nuk shënoi progress në përmirësimin e 44 indikatorëve vlerësues bazuar në metodologjin e vlerësimit në këtë transprometër komuna. Në gjashtë mujorin e parë nga 8.1

pikë mestare për katër shtyllat e vlerësimit është vlerësuar me 10.3 pikë mesatare në gjashtë mujorin e dytë. Shtylla me më pak përmirësime të indikatorëve vlerësues mbetet shtylla e ekzekutivit /Zyra e Kryetarit me vetëm 4.3 pikë nga 35.0 pikë sa është edhe maksimalja e pikave për cdo shtyllë të vlerësimit.

■ Korrik - Dhjetor 2016  
■ Janar - Qershor

PIKËT MESATARE



Kuvendi i Komunës



Ekzekutivi



Financa



Konsultime




# **TRANSPARENCA NË KOMUNË**



# TRANSPARENCA NË

## RAHOVEC (PDK)



Korrik - Dhjetor 2016

Komuna e Rahovecit del të jetë komuna e parë më transparente në kuadër të komunave të regjionit të Prizrenit me 79.7 % të nivelit të përgjigjëm bazuar në 44 indikatorë.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Kuvendi i Komunës së Rahovecit del të jetë më transparent në krahasim me komunat tjera të regjionit të Prizrenit me 30.0 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Rahovecit qëndron mirë në *“seancat e hapura për publikun”*, *“qasja në rendin e ditës”*, *“qasja në draft rregullore dhe plane”* *“qasje në rregulloret dhe vendimet”*. *“mbajtjen e seancave të rregullta”*, *“qasja ne procesverbalet e mbledhjeve te Kuvendit të Komunës ‘plani i punës së Kuvendit për vitin 2016’, si dhe publikimi i ‘planit për transparencë për vitin 2016’.*

Relativisht mirë qëndron në këta indikatorë”, *“detajet biografike dhe kontaktet me anëtarë të Kuvendit të Komunës”*, *“Komitetet e hapura për publikun”*. Edhe gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka qëndruar negativisht në pamundësinë e transmetimit direkt të seancave të kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit duhet të shtojë përpjekjet për transparencë më të madhe të punës së Komiteteve dhe Komisioneve si trupa ndihmës së këtij institucioni. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Rahovecit nuk ka

bërë sa duhet në njoftimet për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve sidomos të mbledhjes së Komisioneve të formuara nga ana e Kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë kësaj periudhe nuk ka rritur nivelin e transparencës së Kuvendit përmes transmetimit direkt të mbledhjeve të këtij institucioni. Ky institucion duhet të shikojë mundësitë reale për të transmetuar seancat e mbledhjeve në ndonjë medium lokal që do të ndikonte në rritjen e transparencës së punës dhe rritjen e nivelit të përgjegjësisë së anëtarëve karshi qytetarëve.



**“Transparenca e Ekzekutivit”.** Nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 27.0 pikë është vlerësuar transparencja e ekzekutivit të Komunës së Rahovecit, dhe në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës qëndron më dobët. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar *“planin e punës së Kryetarit për vitin 2016” si dhe “Kryetari i Komunës nuk ka raportuar për punën e tij gjashtë mujore në Kuvendin e Komunës”.*

Kryetari i Komunës së Rahovecit duhet të publikojë në ëeb faqen zyrtare të Komunës Planin e Punës për vitin 2016 si dhe të ketë gatishmërinë e raportimit në baza gjashtë mujore për punën e ekzekutivit të komunës. Njëkohësisht, Kuvendi i Komunës së Rahovecit duhet të shtojë përpjekjet



për mbikëqyrjen dhe kërkesë në raport me ekzekutivin e komunës për raportime periodike në baza gjashtëmujore.

Megjithatë, Kryetari i Komunës së Rahovecit ka publikuar raportin gjashtë mujor të punës në ueb faqen zyrtare të komunës duke u bërë Kryetari i vetëm i komunave të regjionit të Prizrenit që ka praktikuar deri më tani publikimin e raportit gjashtëmujor të punës në ueb faqen e komunës, i përmbledhur në një raport të vetëm, për gjithë dikasteret e komunës.

Ekzekutivi i Komunës së Rahovecit ka marrë notë maksimale edhe në indikatorin e kthimit të përgjigjeve sipas legjislacionit aktual duke respektuar afatet e caktuara. Një nga vlerësimet tjera maksimale për transparencën e punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit mbetet edhe jetësimi i vizitës javore për qytetarët e kësaj komune si dhe pale tjera të interesit.

Dy nga indikatorët tjerë të vlerësuar në këtë periudhë për ekzekutivin e komunës mbeten kriteret për konkurset publike dhe publikimi i tyre si dhe publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës në baza të rregullta. Ajo çka vlen të vlerësohet në ekzekutivin e komunës së Rahovecit mbetet edhe publikimi i urdhëresave të Kryetarit të Komunës si vendime të tij dhe të vlefshme për institucionet dhe banorët e kësaj komune.

Një nga indikatorët më pak të vlerësuar gjatë kësaj periudhe ka qenë azhurimi i “ueb faqes së komunës në gjuhë tjetër zyrtare” ku kemi pak të dhëna duke mos freskuar në mënyrë paralele me gjuhën tjetër zyrtare.



**“Transparenca Financiar e Komunës”.** Komuna e Rahovecit në transparencën financiare është vlerësuar me 32.3 pikë nga 35 të mundshmet dhe është vlerësuar si shtylla e dytë më transparente në kuadër të katër shtyllave të vlerësuara.

Pikët maksimale ka marr tek *“ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës”, “publikimi në ueb faqen e komunës së raporteve tre mujore financiare si dhe vjetore”, “publikimin e raportit të Auditmit për vitin 2015”, “publikimi i të hyrave vetanke të komunës në baza periodike”, “plani i buxhetit dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale” si dhe publikimi i “listës së pronave dhe asteve komunale të dhëna dhe të marra me qira”.*

Komuna e Rahovecit gjatë kësaj periudhe ka trajtuar me vonës raportin financiar janar-qershor 2016 i cili është shqyrtuar në Kuvendin e Komunës në seancën e muajit gusht dhe raportin janar-shtator 2016, shqyrtuar në Kuvendin e Komunës në muajin nëntor 2016.

Po ashtu Komuna e Rahovecit nuk ka publikuar në kohë të gjitha njoftimet për kontratë dhe dhënie të kontratës paralel me njoftimet në KRRPP.

Në gjashtë mujorin e dytë të këtij viti, Komuna e Rahovecit ka përmirësuar indikatorin relevant në procesin e prokurimit publik të kësaj komune duke bërë publike dhe të qasëshme përmes ueb faqes së komunës planin e prokurimit për vitin 2016.



**“Transparenca në Konsultime me Publikun”.** Komuna e Rahovecit ka marrë 21.3 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Në këtë gjashtë mujorë në vazhdimësi ka respektuar kriteret ligjore në *“njoftimin e publikut nëpërmes formës online dhe offline”, “mbajtja e takimeve të rregullta me qytetarë”, “konsolidimi dhe konsultimi i bashkësive lokale” si dhe “organizimi i dëgjimeve publike dhe buxhetore (KAB)”.*

Komuna e Rahovecit është notuar pozitivisht në disa nga indikatorët si *“material përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore” si dhe “hapjen e të dhënave statistikore (OPEN DATA)”*

Me notë minimale është vlerësuar në katër indikatorë si *“raport nga konsultimet publike dhe dëgjimet buxhetore (KAB)”, “takimet me organizatat e shoqërisë civile” si dhe “listën e hollësishme të ofrimit të shërbimeve nga dikasteret komunal”.*


Po ashtu, me zero (0) pikë është vlerësuar në dy indikatorë si *“linjë direkte telefonike pa pagesë për qytetarë” si dhe “mungesa e krijimit të një faqe në rrjetin social “Facebook”.* Komuna e Rahovecit duhet të shtojë përpjekjet në hartimin e udhëzuesve për secilin dikasterë se si qytetarët mund të ju qasen ofrimit të shërbimeve të caktuara si dhe të krijohen mundësit nga ana e Komunës së Rahovecit që të ofrojë një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët si dhe të krijojë një profilë në rrjetin social “Facebook” me qëllim të interaktivitetit të ndërsjellët qytetarë-komunë.





# TRANSPARENCA NË

## MALISHEVË (NISMA)



Korrik - Dhjetor 2016

Komuna e Malishevës del të jetë komuna e dytë më transparente, me një nivel të transparencës prej 70.9 %. Institucioni më transparent i Komunës së Malishevës është Kuvendi i Komunës në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 26.3 pikë, ndërsa Komuna e Malishevës është më pak transparente në shtyllën e Konsultimit me Publikun ku është vlerësuar me 25.3 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja e vlerësimit.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Komuna e Malishevës qëndron mirë në këto fusha: *“qasja në rendin e ditës”, “takime e seancave të hapura për publik”, “transmetimi i seancave të Kuvendit të Komunës”, “qasja në draft rregulloret dhe planet”, “komitetet e hapura për publikun”, “qasja në rregulloret dhe vendimet të Kuvendit të Komunës” si dhe “mbajtja e seancave të rregullta (10 në vit/5 në gjashtë mujorin e parë)”.*

Gjatë kësaj periudhe të vlerësimit të transparencës së Kuvendit të Komunës, ky institucion ka arritur që secila mbledhje e kuvendit të jetë e hapur për publikun si dhe janë përmirësuar kushtet në sallën e kuvendit për pjesëmarrjen e publikut, gjatë kësaj periudhe ka filluar kë transmetoj direkt seancat e Kuvendit në faqen zyrtare facebook, dhe radio lokale si dhe ka plotësuar obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve për këtë gjashtë mujor.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe vlerësuese, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka qëndruar mirë në njoftimin me kohë për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve obligative si dhe komiteteve të tjera që i ka themeluar Kuvendi i Komunës së Malishevës. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës ka marrë vendim për diskutim publik të Rregullores komunale për transparencë si Rregulloren komunale për mirëmbajtjen e varrezave.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe nuk kem plotësim të mëtejme të detajeve biografike për anëtarë të Kuvendit të Komunës megjithatë të pasqyruara kanë qenë kontaktet dhe emali adresat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës së Malishevës në vitin e kaluar kishte marrë vendim që procesverbalet e mbledhjeve të këtij institucioni të publikohen në ueb faqen e komunës. Edhe përkundër këtij vendimi, Kuvendi i Komunës së Malishevës vazhdon të mos i pasqyrojë procesverbalet e mbledhjeve në ueb faqen e komunës duke u vlerësuar me pike negative edhe gjatë periudhës së dytë të këtij viti.

Komuna e Malishevës ka vazhduar të injorojë obligimet ligjore sa i përket publikimit të planit për transparencë për vitin 2016 duke u bërë komuna e dytë e regjionit të Prizrenit e cila nuk e ka publikuar një plan të till në ueb faqen e komunës.





**“Transparenca e Ekzekutivit të Komunës”**. është vlerësuar me 22.0 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja e pikëve. Ekzekutivi i Komunës qëndron mirë në katër nga 11 indikatorë: *“zyrtarë për informim & koordinator për qasje në dokumente publike”*, *“vizita javore të kryetarit për pritjen e qytetarëve”*, *“publikimi i konkurseve për punësim dhe kriteret në ueb-faqe”*.

Komuna e Malishevës gjatë kësaj periudhe nuk është vlerësuar maksimalisht në disa indikatorë si: *“publikimi i raportit të punës së Kryetarit në ueb faqen e Komunës”*, *“niveli i kthimit të përgjigjeve për kërkesat për qasje në dokumente publike”*, si dhe *“detajet biografike dhe kontaktet (numri kontaktues dhe email adresat) në ueb faqen e komunës”*, *“publikimi i PZHK-së dhe planeve tjera urbane”*.

Komuna e Malishevës nuk është vlerësuar maksimalisht në këta indikatorë për shkak të vonesës së publikimit të raportit të punës së Kryetarit të Komunës për periudhën e parë të këtij viti si dhe vonesës në respektimin e legjislacionit në kthimin e përgjigjeve për qasje në dokumente publike. Po ashtu, Komuna e Malishevës nuk ka azhuruar më tej detajet biografike të drejtorëve të drejtorive komunale.

Në këtë shtyllë, Komuna e Malishevës ka vazhduar te jetë jo-transparente në disa prej indikatorëve vlerësues. *“Publikimi i planit të punës së Kryetarit në ueb faqen komunës”*, *“raporti i punës së Kryetarit në Kuvend”* si dhe *“azhurnimin e ueb faqes së komunës në gjuhë tjetër zyrtare”*. Në tre këta indikatorë vlerësues, kjo komunë nuk i ka përmbushur kriteret vlerësuese, ndaj Kryetari i Komunës duhet të shtojë përpjekjet në publikimin e planit të punës si dhe në përmirësimin e transparencës në gjuhën tjetër zyrtare. Po ashtu Kuvendi i Komunës duhet të kërkojë llogaridhënie më të madhe në raport me ekzekutivin e komunës duke kërkuar që në baza të rregullta të raportojë për punën e tij pranë institucionit të Kuvendit.



**“Transparenca Financiar e Komunës”**. Në raport me transparencën e Zyrës së Kryetarit, në transparencë financiare kjo komunë është treguar për një nuancë më e dobët duke akumuluar 25.7 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja.

Pikët maksimale ka marr tek *“ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin Komunal”*, *“publikimi i raportit të shpenzimeve tre mujore në ueb faqen e komunës”*, *“publikimi i raportit të auditorit të përgjithshëm për vitin 2015”*, *“publikimin e planit të prokurimit për vitin 2016”*, *“publikimi listës së pronave dhe asetëve komunale të dhëna dhe të marra me qira”*, *“publikimi i të hyrave vetanake të komunës*

*në ueb faqen e komunës”* si dhe në *“njoftimi për kontratë dhe dhënien e kontratave në ëeb faqen e komunës”*

Komuna e Malishevës është vlerësuar negativisht në këtë indikatorë: *“borxhi publik komunal (borxh kompanive”*. Në këtë indikatorë është vlerësuar negativisht për shkak së në këtë periudhë, Komuna e Malishevës nuk ka publikuar në ueb faqen e komunës borxhin publik komunal në baza periodike.



**“Transparenca në Konsultime me Publikun”**. Në këtë gjashtë mujor Komuna e Malishevës ka marrë 25.3 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja duke bërë përpjekje në përfshirjen e qytetarëve në hartimin e politikave publike. Në këtë periudhë vetën në njërin nga 11 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë ka marrë notë negative duke mos arritur të sigurojë një *“linjë telefonike pa pagesë për qytetarët”*.

Në këtë periudhë më nota maksimale është vlerësuar në këta indikatorë: *“njoftimi online dhe ofline për takimet publike”*, *“organizimi i takimeve të rregullta me qytetarë”*, *“organizimi i dëgjimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore”*, *“material përcjellës për dëgjimet buxhetore”* si dhe *“rifereskimi i ueb faqes së Facebook-ut”*.

Me nota minimale Komuna e Malishevës qëndron në këta indikatorë: *“raport nga konsultimet e publikut dhe dëgjimet buxhetore (KAB)”*, *“listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun”*.

Komuna e Malishevës nuk ka arritur të ofrojë raport të detajuar nga mbajtja e organizimeve të konsultimeve të politikave publike me publikun dhe dëgjimet buxhetore. E vetmja informatë në mbajtjen e këtyre konsultimeve dhe dëgjimeve ka qenë informata në ueb faqen e komunës në formë të lajmeve duke mos i arhivuar si raporte apo procesverbale të këtyre organizimeve.


Komuna e Malishevës duhet të shtojë përpjekjet maksimale në përmirësimin e indikatorëve kyç sidomos në listën e ofrimit të shërbimeve për secilën drejtori dhe format, procedurat e marrjes së atyre shërbimeve si dhe në publikimin e të dhënave të tjera statistikore për komunën.





# TRANSPARENCA NË

## PRIZREN (PDK)



Komuna e Prizrenit del të jetë komuna e katërt më transparente, me një nivel të transparencës prej 58.5 %. Institucioni më transparent i Komunës së Prizrenit është shtylla e financave, në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 26.3 pikë, ndërsa Komuna e Prizrenit është më pak transparente në shtyllën e Konsultimeve me publikun ku është vlerësuar me nga 15.3 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja e vlerësimit.



**“Transparenca Financiar e Komunës”.** Komuna e Prizrenit gjatë periudhës vlerësuese të transparencës në këtë shtyllë ka arritur të akumulojë 26.3 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja vlerësuar në 11 indikatorë bazik.

Sipas të dhënave të mbledhura për këtë hulumtim, vlerësimin më të lartë ka marr tek *“ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës”*, *“raporti i shpenzimeve tre mujore të publikuara në ueb faqen e komunës”*, *“publikimi i raportit të auditorit të përgjithshëm”* *“publikimi i të hyrave vetanake të komunës”*, *“publikimi i njoftimeve për kontratë dhe për dhënien e kontratës në ueb faqen e komunës”* si dhe *“lista e pronave (zyre, lokale) në pronësi dhe të marra me qira për komunën”*.

Në gjithë këta indikatorë, Komuna e Prizrenit është vlerësuar maksimalisht për faktin e respektimit të afateve dhe procedurave për ardhjen në kuvend të ndryshimeve buxhetore (rishikimi i buxhetit) edhe përkundër mos miratimit të tij në Kuvend, si dhe

ka respektuar legjislacionin bazë në publikimin e raporteve tre mujore financiare.

Me nota të mirë është vlerësuar edhe në këta indikatorë si: *“diskutimi brenda afateve ligjore në Kuvend të shpenzimeve tre mujore”*, *“plani dhe buxheti i projekteve kapitale për vitin 2016”*, si dhe *“publikimi i kontratave”*. Gjatë kësaj periudhe, KDI ka testuar gatishmërinë e Komunës së Prizrenit në publikimin e kontratave me Operatorët Ekonomik dhe të njëjtat kontrata nuk janë ofruar në tërësi në bazë të kërkesave të parashtruara.

Minimalisht është vlerësuar në vetëm në një indikatorë tek *“publikimi i planit të prokurimit për vitin 2016”*. Komuna e Prizrenit është vlerësuar kështu për arsye se nuk e ka publikuar planin e prokurimit për vitin 2016 në ueb faqen e komunës mirëpo Kuvendi i Komunës në njërin nga seancat e vitit 2016 ka shqyrtuar planin e till i ofruar nga Zyra e Prokurimit duke krijuar një praktikë të re në përpjekjet për transparencë më të madhe në prokurimin publikë karshi Kuvendit të Komunës.

Ndërsa mungesë të transparencës Komuna e Prizrenit ka treguar tek *“mos publikimi i borxhit publik komunal në ueb faqen e komunës”*. Komuna e Prizrenit ka dështuar në publikimin e borxhit publik komunal duke mos pasqyruar obligimet ndaj Operatorëve Ekonomik në kuadër të raporteve tre mujore financiare.





**“Transparenca e Ekzekutivit”.** Transparenca e Ekzekutivit është vlerësuar me 17.3 nga 35 pikë maksimale. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar me notë maksimale vetëm në 2 nga 11 indikatorët e kësaj shtylle si: *“vendimet e kryetarit të Komunës” si dhe “zyrtarë për informim dhe koordinim për qasje në dokumente publike”, “Konkursi dhe kriteret në ueb faqe për punësim”.* Po ashtu, në 5 nga 11 indikatorët është vlerësuar më notë të mirë megjithatë nuk ka qenë plotësisht transparentë në këtë gjashtëmujorë. *“niveli i kthimit të përgjigjeve për qasje në dokumente publike”, “publikimi i planeve urbanistike të komunës”, “detajet biografike të Kryetarit dhe Drejtoreshave të drejtorive komunale” si dhe “ueb faqja e azhuruar në gjuhë tjera zyrtare”.*

Gjatë kësaj periudhe, komuna e Prizrenit në kërkesat për qasje në dokumente publike nuk ka respektuar afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve duke u vonuar dhe shkaktuar vonesa si dhe në një rast të caktuar nuk ka kthyer përgjigje fare.

Ekzekutivi i Komunës së Prizrenit është vlerësuar negativisht në 3 nga 11 indikatorët e kësaj shtylle. Gjatë kësaj periudhe ekzekutivi i komunës nuk kishte të publikuar planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2016, nuk është praktikuar dhe vendosur për një ditë të caktuar për pritjen e qytetarëve dhe palëve tjera të interesit si dhe Kryetari i Komunës nuk ka raportuar në Kuvend për punën e tij gjashtëmujore.

Me notë minimale në këtë periudhë, zyra e kryetarit është vlerësuar në indikatorin e publikimit të raportit të punës në ueb faqen e komunës për periudhën gjashtë mujore. Vetëm disa nga drejtoritë komunale të ekzekutivit të komunës kanë të publikuara raportet e punës për periudhën janar-qershor 2016 duke bërë që puna e qeveris lokale në baza periodike të jetë fare pak transparente.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Është shtylla e dytë me nivel më të lartë të transparencës pas transparencës financiare me 23.0 pikë nga 35 sa është maksimalja e pikëve. Komuna e Prizrenit qëndron mirë në këto fusha: *“takime e seancave të hapura për publik”, “transmetimi i drejtpërdrejt i seancave të kuvendit të komunës”, “numri i mbajtjes së seancave të rregullta sipas legjislacionit”, “publikimi i planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016 në ueb faqen e komunës” si dhe “publikimi i planit të veprimt për transparencë”.*

Gjatë kësaj periudhe 2 nga 11 indikatorët vlerësues, kuvendi ka marrë nota të mira në *“qasjen në rendin e ditës për mbledhjet e kuvendit të komunës”, “qasja në draftet e rregulloreve dhe planet”, “komitetet e hapura me publikun” si dhe “qasja në rregulloret komunale dhe vendimet”.* Këtë vlerësim ka arritur

për shkak të njoftimeve me kohë për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe njoftimi për pikat e rendit të ditës.

Po ashtu, Kuvendi i Komunës është treguar transparent sa i përket publikimit të vendimeve të këtij institucioni mirëpo disa nga rregulloret e miratuara në këtë institucion nuk kanë qenë të publikuara në ueb faqen e komunës së Prizrenit.

Me nota minimale, Kuvendi i Komunës është vlerësuar tek indikatorin vlerësues *“detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të kuvendit”*, ku edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur azhurim të detajeve biografike për anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka treguar mos transparencë totale vetëm në një nga 11 indikatorët. Deri më tani asnjë nga procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës gjatë periudhës korrik-dhjetor 2016 nuk kanë qenë të pasqyruara në ueb faqen e komunës.



**“Transparenca në Konsultime me Publikun”.** Kjo komunë ka marrë 15.3 pikë nga 35.0 pikë të mundshme. Komuna e Prizrenit, ka mbajtur *“organizimin e dëgjimeve publike dhe dëgjimet buxhetore (1 për 25 mijë banorë), “njoftimet online dhe offline për takimet publike”* duke u vlerësuar maksimalisht në këtë periudhë.

Komuna e Prizrenit është vlerësuar mirë në organizimin e konsultimeve publike ku gjatë kësaj periudhe ka organizuar debat me qytetarë për projekt buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin fiskal 2017 si dhe njoftimet online dhe offline për takimet publike përmes ueb faqes së komunës dhe mekanizmave tjera. Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka organizuar dëgjime publike me Kryetarë të bashkësive lokale për projekt-buxhetin e komunës për vitin 2017.


Me nota minimale në këtë shtyllë janë vlerësuar 4 nga 11 indikatorët bazë, tek: *“hapja e të dhënave statistikore (open data)”, “listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun” si dhe nuk ka organizuar takime me organizatat e Shoqërisë Civile.*

Dy nga indikatorët vlerësuar në këtë shtyllë janë vlerësuar negativisht për shkak se komuna e Prizrenit nuk ka filluar të praktikojë mbajtjen e raporteve apo procesverbaleve gjatë organizimit të konsultimeve për politika publike dhe dëgjimet buxhetore. Po ashtu, edhe në këtë gjashtë mujorë të këtij viti, komuna e Prizrenit nuk ka arritur të këtë një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët e saj.



# TRANSPARENCA NË

## SUHAREKË (LDK)



Komuna e Suharekës del të jetë komuna e katërt më transparente në kuadër të komunave të regjionit të Prizrenit me 58.0 % të nivelit të përgjithshëm bazuar në 44 indikatorë.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Komuna e Suharekës është vlerësuar me 27.3 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Suharekës qëndron mirë në *“seancat e hapura për publikun”*, *“transmetimi i drejtpërdrejt i seancave të kuvendit”*, *“qasja në procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit”*, *“qasja në rregulloret dhe vendimet”*, si dhe *“mbajtja e seancave të rregullta sipas legjislacionit në fuqi”*.

Gjatë kësaj periudhe komuna e Suharekës në njërin nga mbledhjet e parapara të Kuvendit të Komunës, nuk ka njoftuar në ueb faqen e komunës duke mos respektuar legjislacionin në fuqi që detyron komunat të kenë njoftimin në ueb faqen e komunës si dhe pikat e rendit të ditës për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Megjithatë, në seancat tjera të mbajtura në këtë periudhë ka respektuar afatet e njoftimit të publikut dhe pasqyrimin e pikave të rendit të ditës si dhe ka publikuar materialet përcjellëse për secilën pikë të rendit të ditës.

Disa nga indikatorët që janë vlerësuar relativisht mirë mbetet *“qasja në rendin e ditës”*, *“qasja në drafte e rreg-*

*ulloreve dhe planet”*, *“hapja e komiteve për publikun”*, *“detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit”* si dhe *“plani i veprimit për transparencë”*.

Kuvendi i Komunës së Suharekës edhe në këtë gjashtë mujor ka vazhduar me mungesë të transparencës së punës së Komiteteve duke mos njoftuar me rregull për mbajtjen e mbledhjeve të këtyre mekanizmave pos të mbledhjes së Komitetit për Politik dhe Financa dhe Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) si dhe njoftimi për pasqyrimin e trajtimit të çështjeve në kuadër të mbledhjeve.

Tek *“publikimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2016”*, Kuvendi i Komunës së Suharekës nuk ka marrë asnjë notë të mundshme, duke mos publikuar planin e till edhe gjatë mujorit të dytë të këtij viti.



**“Transparenca e Ekzekutivit”.** Nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 19.3 pikë është vlerësuar transparenca e ekzekutivit të Komunës së Suharekës dhe nga të dhënat finale del që edhe në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016, ekzekutivi i komunës qëndron me dobët në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës.

Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar me mos publi-



kimin në ueb faqe “raportin gjashtë-mujor të Punës”, nuk ka “raportuar Kryetari në Kuvend (2 herë në vit)”, nuk ka “publikuar Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2016” si dhe “nuk i ka pasqyruar vendimet e Kryetarit të Komunës” gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Suharekës qëndron mirë në katër (4) indikatorë: “Zyrtarë për informim & Koordinim. për qasje në dokumente publike”, “niveli i kthimit të përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike”, “praktikimi i një dite të veçantë për pranimin e vizitave për qytetarë”, “konkurset për punësim dhe kriteret në ueb-faqe”, “detajet biografike të Kryetarit/es dhe Drejtorëve (Emal adresa), si dhe “Planet Zhvillimore të Komunës (PZHU) & Plani Urban i Komunës”.



**“Transparenca Financiar e Komunës”.** Komuna e Suharekës në transparencën financiare është vlerësuar me 28.3 pikë nga 35 të mundshmet

Edhe gjatë gjashtë muajit të dytë të vitit 2016, Komuna e Suharekës është vlerësuar me pikë maksimale në 6 nga 11 indikatorët vlerësues për këtë shtyllë dhe mbetet një nga shtyllat më transparente gjatë kësaj periudhe bazuar në indikatorët matës për këtë fushë. Komuna e Suharekës po ashtu mbetet komuna e vetme e cila e ka publikuar planin e prokurimit për vitin 2016 në ueb faqen e komunës.

“Ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës”, “publikimi i raportit tre mujor financiar në ueb faqen e komunës”, “publikimi i raportit të auditorit”, “publikimi i listave të pronave dhe asetëve komunale të dhëna dhe të marra me qira”, “publikim i planit të prokurimit “si dhe “publikimi i kontratave” janë indikatorët që janë vlerësuar maksimalisht gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Suharekës dobët qëndron tek publikimi i “borxhit publik komunal (borxh kompanive)”, ku gjatë raportimeve tre mujore financiare nuk ka pasqyruar obligimet eventuale të komunës ndaj Operatorëve Ekonomik.



**Transparenca në Konsultime me Publikun”.** Kjo komunë ka marrë 20.3 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Komuna e Suharekës në këtë gjatë gjashtëmujorit të dytë 2016 në vazhdimësi ka respektuar kriteret ligjore në njoftimin e publikut online dhe offline, mbajtja e takimeve të rregullta me qytetarë, organizimi i dëgjimeve publike për politikat publike dhe dëgjimet buxhetore si dhe ka ri freskuar në vazhdimësi faqen e facebook-ut.

Komuna e Suharekës ishte në nivel të njoftimit të publikut për organizimin e takimeve dhe dëgjimeve për politikat lokale. Kryetari i Komunës së Suharekës ka mbajtur takimin e rregullt me qytetarë sipas legjislacionit në fuqi.


Komuna e Suharekës në 4 nga 11 indikatorët e vlerësuar në këtë shtyllë ka marrë notë minimale duke mos arritur përmirësime të dukshme në përfshirjen e qytetarëve në vendimarrjen lokale. Nga këto indikatorë që ka çaluar komuna e Suharekës janë: “mbajtja e raporteve nga organizimet e konsultimeve dhe dëgjimeve për politikat publike”, “hapja e të dhënëve statistikore (open data)” si dhe “mungesa e organizimeve të takimeve nga ana e komunës me organizatat e shoqërisë civile”, “listën e ofrimit të shërbimeve dhe procedurat e marrjes së tyre nga institucioni.

Komuna e Suharekës qëndron negativisht në “material përcjellës për qytetarët nga organizimet dhe dëgjimet për politikat publike”, “linje telefonike direkt pa pagesë për qytetarët”. Komuna e Suharekës edhe gjatë periudhës së dytë të vitit 2016 nuk ka arritur të sigurojë një linjë telefonike pa pagesë duke u pa mundësuar qytetarëve të saj qasje më të lehtë në institucionet e tyre.



# TRANSPARENCA NË

## DRAGASH (PDK)



Korrik - Dhjetor 2016

Përkundër përmirësimit të vazhdueshëm të transparencës, Komuna e Dragashit vazhdon të jetë komuna e pestë më transparente në kuadër të komunave të regjionit të Prizrenit me 58.4 % të nivelit të përgjithshëm bazuar në 44 indikatorë.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Komuna e Dragashit është vlerësuar me 22.7 pikë nga 35.0 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Dragashit qëndron mirë vetëm në indikatorët: *“qasja në rendin e ditës”, “seancat e hapura për publikun”, “qasja në rregullore dhe vendime”, “mbajtjen e seancave të rregullta” si dhe publikimi i “planit të veprimit për transparencë”.* Në këta indikatorë vlerësues, Kuvendi i Komunës është notuar me pikët maksimale të vlerësimit.

Transparenca e Kuvendit të Komunës vazhdon të jetë e mbyllur në disa prej indikatorëve vlerësues duke mos arritur të publikojë planin e punës së Kuvendit të Komunës. Komuna e Dragashit duhet të bëjë publike planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017 duke krijuar praktika të mira në hapjen e transparencës në punën e këtij institucioni.

Në disa prej indikatorëve vlerësues, shtylla e kuvendit të komunës ka marrë nota relativisht të mira duke arrit të jetë pjesërisht transparente në *“transmetimin e drejtpërdrejt të seancave të kuvendit”, “qasjen e publikut në draftet e rreg-*

*ulloreve dhe planeve”, “qasja në procesverbale”, “qasja në draft rregullore dhe plane” si dhe “komitetet e hapura për publikun”, “detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të kuvendit të komunës”.*

Kuvendi i Komunës duhet të shtojë përpjekjet në përmirësimin e këtyre indikatorëve sidomos në transparencën dhe përfshirjen e publikut në punën e komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit të Komunës. Në këtë gjashtëmuor të këtij viti, në vazhdimësi kanë munguar njoftimet e publikut për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve të Kuvendit duke mos respektuar legjislacionin në fuqi për njoftimet përkitazi të mbledhjeve në ëeb faqen e komunës.



**“Transparenca e Ekzekutivit”.** Në 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 15.0 pikë është vlerësuar transparenca e ekzekutivit të Komunës së Dragashit, dhe në raport me tri shtyllat tjera vazhdon të qëndroj me dobët.

Ekzekutivi i komunës, me notë maksimale është vlerësuar vetëm në një indikatorë, *“konkurs për punësim dhe kriteret e punësimit në ueb faqe”, “publikimi i vendimeve të kryetarit”. Relativisht mirë kjo komunë ka qëndruar tek “PZHK dhe planet tjera urbane”, dhe “detajet biografike të kryetarit & drejtorëve” si dhe “azhurnimi i ueb faqes së Komunës në gjuhë tjetër zyrtare”.*





Komuna e Dragashit edhe në këtë gjashtë mujor ka vazhduar me hendekun rreth caktimit të Zyrtarit për Informim në këtë komunë, duke mbetur një nga komunat e pakta që nuk ka zyrtarin e till të rekrutuar. Aktualisht, drejtori i administratës në këtë komunë, mbetet koordinatori për kërkesat për qasje në dokumente publike që parashtrihen në këtë institucion.

Në katër nga 11 indikatorët, Komuna e Dragashit është notuar negativisht. Mungesa e publikimit të raportit të punës gjashtëmujor në ueb faqen e komunës, mungesa e publikimit të planit të punës së Kryetarit për vitin 2016 si dhe moshgatishmëria e Kryetarit në caktimin e një ditë të veçantë për pritjen e qytetarëve dhe palëve tjera të interesit si dhe raportimi i Kryetarit të Komunës në Kuvendin e Komunës mbesin indikatorët mos përmbushës edhe në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016.



**“Transparenca Financiar e Komunës”.** Komuna e Dragashit në transparencën financiare është vlerësuar me 25.7 pikë nga 35 pikë të mundshme. Çka bën që kjo shtyllë të jetë më e vlerësuar për periudhën korrik-dhjetor 2016, krahasuar me shtyllat tjera për sa i përket transparencës së institucioneve komunale. Pikët maksimale ka marr tek *“ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin Komunal”*, *“publikimi i shpenzimeve tremujore”*, *“publikimi i raportit të auditimit për vitin 2015”*, *“diskutimi në kuvend brenda afatëve ligjore i raporteve tre mujore financiare”*, *“listat e pronave (zyrat, lokalet etj) në pronësi dhe të marra me qira për Komunën”*, *“publikimi i të hyrave vetanake të komunës”* si dhe *“njoftimi për kontratë dhe dhënie të kontratës”*.

Komuna e Dragashit qëndron relativisht mirë tek *“plani, buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale”*, si dhe *“publikimi i njoftimeve për kontratë dhe për dhënie të kontratës”*.

Mirëpo edhe tek kjo shtyllë vlerësuese Komuna e Dragashit në gjithsejtë dy indikator është vlerësuar negativisht. Mungesa e publikimit të borxheve të komunës ndaj operatorëve ekonomik në baza periodike si de mos publikimi i planit të prokurimit për vitin 2016 mbesin indikatorët të vlerësuar negativisht në këtë shtyllë të transparencës komunale.



**“Transparenca në Konsultime me Publikun”.** Komuna e Dragashit ka marrë 18.3 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar, kjo komunë ka bërë përpjeke në përmirësimin e transparencës dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen komunale.

Mirëpo edhe në këtë periudhë gjashtëmujore në shtyllën e transparencës së konsultimeve me publikun, 3 nga 11 indikatorët janë vlerësuar me notë negative 0. Komuna e Dragashit qëndron negativisht në *“raportin nga konsultimet me publikun”*, mungesa e një *“linje telefonike pa pagesë për qytetarët”*, si dhe *“freskimi i faqes së Facebookut”*. Edhe në këtë gjashtë mujor, gjatë organizimeve të takimeve dhe dëgjimeve për politikën lokale, komuna e Dragashit nuk praktikon mbajtjen e procesverbaleve dhe publikimin e tyre në ueb faqen e komunës.

Po ashtu komuna e Dragashit me nota minimale është vlerësuar tek, *“konsolidimi dhe konsultimi i bashkësive lokale”*, *“takimet me organizatat e shoqërisë civile”*, dhe *“listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun”*.

Komuna e Dragashit duhet të shtojë përpjekjet në rritjen e nivelit të pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale duke ofruar materialet përcjellëse në konsultimet dhe dëgjimet buxhetore (KAB), duhet të konsultohet në baza periodike me përfaqësuesit e bashkësive lokale si dhe organizime me organizatat e shoqërisë civile. Po ashtu duhet të ofrojë edhe listën e ofrimit të shërbimeve nga dikasteret komunal si dhe formën, mënyrën dhe procedurat e marrjes së shërbimeve të tilla nga ana e qytetarëve.

Vetëm në 2 indikatorë kjo komunë ka marrë vlerësim të mirë ku dhe është vlerësuar me notë maksimale. Kjo komunë ka mbajtur *“takimet e rregullta me qytetarët”*, ka njoftuar publikun për *“njoftimet online dhe offline për takimet publike”* dhe ka organizuar dëgjime publike dhe dëgjime buxhetore në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016”.








# TRANSPARENCA NË

## MAMUSHË (KTAP)



Korrik - Dhjetor 2016

Komuna e Mamushës, vazhdon të jetë komuna me më së paku transparencë në kuadër të komunave të regjionit të Prizrenit me 29.4 % të nivelit të përgjithshëm bazuar në 44 indikatorë. Komuna e Mamushës ende vazhdon të qalojë në pothuaj se në mbi 55 % të indikatorëve të cilët përbëjnë katër shtyllat vlerësuese duke mos arritur progres në përm-bushjen e obligimeve bazë të transparencës institucionale.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Gjatë kësaj periudhe Komuna e Mamushës është vlerësuar me 12.3 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Në këtë shtyllë, Komuna e Mamushës qëndron mirë vetëm në “se-ancat e hapura për publikun”, dhe “mbajtjen e seancave të rregullta” duke marrë pikët maksimale të vlerësimit.

Ndërsa tek “qasja në rregulloret, dhe vendimet” si dhe “de-tajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës”, Komuna e Mamushës ka marrë nota minimale dhe është vlerësuar me vetëm nga një pikë, pasi që infor-matat në to kanë qenë tejet të mangëta dhe vështirë të qasshme për publikun.

Derisa, në indikatorët si “transmetimi i drejtpërdrejtë i se-ancave”, “qasja në draft rregulloret dhe planet”, “qasja në procesverbalet”, “qasja në planin e punës së Kuvendit”, dhe mungesa e “planit të veprimit për transparencë”, kanë

qenë indikatorët në të cilët komuna e Mamushës nuk ka marrë asnjë notë të mundshme.



**“Transparenca e Ekzekutivit”.** Nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve, me 4.3 pikë është vlerësuar transpar-enca e ekzekutivit të Komunës së Mamushës ku në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës qëndron shumë më dobët. Ekzekutivi i komunës së Mamushës është vlerë-suar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar “raportin gjashtë-mujor të punës”, nuk ka “raportuar Kryetari në Ku-vend (2 herë në vit)”, ai po ashtu “nuk ka praktikuar as vizita javore me qytetarë”, “në ueb-faqen e komunës nuk kanë qenë të përfshira informatat për punësim dhe kriteret tjera”, “mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës”, si dhe kanë munguar “Planet Zhvillimore të Komunës (PZH) dhe Plani Urban i Komunës”.

Mirëpo ekzekutivi komunal, pak më mirë ka qëndruar tek indikatorët si, dhe “detajet biografike të Kryetarit/es dhe Drejtorëve, ku është vlerësuar me nga dy pikë, derisa vlerë-sim minimal, kanë marrë indikatorët, si “zyrtar për informim dhe koordinator për qasje në dokumente zyrtare” dhe “për-ditësimi i ëeb-faqes në gjuhët tjera zyrtare” kategori këto që kanë marrë vetëm nga një pikë.





**“Transparenca Financiar e Komunës”.** Pothuaj se plotësisht jo transparente, Komuna e Mamushës vazhdon të jetë tek financat komunale, me performancë tejjet të dobët me vetëm 11.3 pikë nga 35 pikët e mundshme në këtë shtyllë. Asnjë dokument financiar, raport i shpenzimeve apo të tjetër financiar e buxhetor nuk është i qasshëm në këtë komunë. Po ashtu *“mos publikimi i planit të Prokurimit”, “njoftimet për kontratë dhe dhënie të kontratës”,* mungesa e evidentimit të *“pasurisë së komunës si lista e pronave (zyrat, lokalet, etj)”*, janë vetëm disa nga shumica e indikatorëve ku Komuna e Mamushës është vlerësuar me notë zero. Të vetmet dy pikë maksimale në korrik-dhjetor 2016 që ka marrë Komuna e Mamushës në transparencën financiare mbetet *“ndryshimi buxhetor i miratuar nga Kuvendi i Komunës” dhe “publikimi i kontratave”.*



**“Transparenca në Konsultime me Publikun”.** Komuna e Mamushës, sa i përket transparencës institucionale, nuk qëndron më mirë as tek konsultimet me publikun. Kjo komunë ka marrë 13.3 pikë nga 35.0 sa është maksimalja. Gjatë kësaj periudhe Komuna e Mamushës ka qëndruar mirë dhe është vlerësuar me notë maksimale në vetëm një indikatorë, në *“takimet e rregullta me qytetarë” si dhe “organizimin e dëgjimit buxhetor për projekt buxhetin e vitit 2017”* derisa më notë minimale është vlerësuar në tre indikatorë, *“njoftimi online dhe offline për takimet publike”, “takimet me organizatat e shoqërisë civile”, si dhe “freskimi i faqes së Facebookut.”*

Mirëpo, sipas të dhënave të verifikuara, Komuna e Mamushës në këtë periudhë, me nota negative është vlerësuar në më shumë se gjysmën e indikatorëve që e përbëjnë këtë shtyllë; si mungesa e raporteve nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet, materiali përcjellës qytetarëve për dëgjimet publike dhe buxhetore, mungesa e një linje telefonike pa pagesë për qytetarë, mos hapja e të dhënave statistikore OPEN-DATA, etj.



# REKOMANDIMET

## KOMUNA E RAHOVECIT

- **Kuvendi i Komunës të hapet për publik:** Kuvendi i Komunës të hapet për publik: Kuvendi i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit në mënyrë që qytetarët të kenë qasje në to.
- **Zyra e Kryetarit:** Kryetari i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe planin vjetor të punës dhe raportin gjashtë-mujor të punës.
- **Transparenca Financiare:** Zyra e kryetarit të Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe planin vjetor të prokurimit.
- **Transparenca në Konsultime me Publikun:** Komuna e Rahovecit duhet të sigurojë një linjë direkte (gratis) për bregat e qytetarëve.

## KOMUNA E MALISHEVËS

- **Kuvendi i Komunës të hapet për publik:** Kuvendi i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe të gjitha procesverbalet e Kuvendit.
- **Zyra e Kryetarit:** Kryetari i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe planin vjetor të punës
- **Transparenca Financiare:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe Borxhin Publik Komunal
- **Linjë Telefonike direkte gratis:** Zyra e Kryetarit të krijojë një linjë telefonike direkte tek zyra për informim, po qe e mundur gratis për qytetarët, që të mund të bëjnë kërkesat e tyre lehtë, japin propozime dhe të udhëzohen përmes telefonit për qasje në informata publike.

## KOMUNA E PRIZRENIT

- **Kuvendi i Komunës të hapet për publik:** Kuvendi i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe të gjitha procesverbalet e Kuvendit.
- **Takime javore me qytetarë:** Kryetari i Komunës duhet ta rezervojë një ditë në javë për vizita me qytetarë që kanë kërkesa dhe propozime për komunën e tyre.
- **Zyra e Kryetarit:** Të raportojë para anëtarëve të Kuvendit për situatën socio-ekonomike dhe për buxhet, (Raport pune, 2 herë në vit sipas legjislacionit në fuqi)
- **Transparenca e shpenzimeve komunale:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe borxhin publik komunal, borxhet e ndërmarrjeve komunale.
- **Komuna e Prizrenit** duhet që të mbajë raporte të rregullta nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore (KAB), si dhe ta publikojë atë në ueb-faqën zyrtare të komunës.
- **Linjë telefonike direkte gratis:** Komuna duhet të ketë një linjë direkte në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën;



## KOMUNA E SUHAREKËS

- **Raportoj aktivitetin gjashtë-mujor:** Zyra e Kryetarit duhet të raportoj para Kuvendit të Komunës raportin e punës në baza gjashtë mujore.
- **Zyra e Kryetarit** po ashtu duhet që ta bëjë publikimin në ueb-faqe të komunës, planin e punës dhe vendimeve të Kryetarit.
- **Transparenca Financiare** – Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe Borxhin Publik Komunal.
- **Të publikohen** njoftimet për kontratë dhe për dhënien e kontratës në aktivitetet e prokurimit.
- **Linjë Telefonike direkte gratis:** Zyra e Kryetarit të ketë një linjë telefonike direkte tek zyra për informim, mundësisht gratis për qytetarët, që të mund të bëjnë kërkesat e tyre më lehtë.
- **Komuna e Suharekës** duhet të publikojë në ueb-faqen e sajë listën e shërbimeve që ofrohen për qytetarët nga dikasteret e ndryshme.

## KOMUNA E DRAGASHIT

- **Qasja në procesverbale.** Transparenca e punës së Kuvendit të Komunës duhet të rritet përmes publikimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit.
- **Kuvendi i Komunës** duhet që të publikojë në ueb-faqe edhe planin vjetor të punës.
- **Regrutimi i Zyrtarit për Informim:** Kryetari i Komunës së Dragashit duhet të fillojë procedurat e rekrutimit të Zyrtarit për Informim, me qëllim të plotësimit të kësaj pozite.
- **Publikimi i aktivitetit gjashtë-mujor:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë raportet gjashtë-mujor të punës së kryetarit në ueb-faqe, planin vjetor të punës si dhe Kryetari duhet të raportojë para anëtarëve të Kuvendit.
- **Transparenca financiare:** Transparenca financiare duhet të rritet ndejshëm pasi që Zyra e Kryetarit duhet ta publikojë në ueb-faqe borxhin publik komunal dhe planin e prokurimit.
- **Transparenca në Konsultime me Publikun:** Komuna e Dragashit në vazhdimësi duhet të paraqesë raport nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore dhe të njëjtin ta publikojë në ueb-faqen zyrtare të komunës.
- **Linjë Telefonike direkte gratis:** Zyra e Kryetarit të ketë një linjë telefonike direkte tek zyra për informim, mundësisht gratis për qytetarët, që të mund të paraqesin kërkesat e tyre.
- **Komuna,** duhet të merrë masa për hapjen e një llogarie të ueb faqes së komunës në rrjetin social të facebook-ut.

## KOMUNA E MAMUSHËS

- **Transparenca e Kuvendit Komunal:** Komuna e Mamushës duhet që të shikojë mundësit për transmetim të drejtpërdrejtë të seancave të Kuvendit, në mënyrë që të informohet opinioni publik për punën e të zgjedhurve të tyre.
- **Kuvendi i Komunës më i qasshëm në ueb:** Kuvendi i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqen zyrtare të komunës planin e punës së Kuvendit, draft-rregulloret, vendimet, planin e veprimit për transparencë, procesverbalet e mbledhjeve si dhe të gjitha detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit si dhe e-mail adresat e tyre.
- **Transparenca e Ekzekutivit të Komunës:** Zyra e Kryetarit: Kryetari i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe raportin gjatë-mujor të punës si dhe të raportoj para Kuvendit në baza gjashtë mujore, të publikoj raportet për konsultime me publikun dhe dëgjimet buxhetore, planet zhvillimore të komunës dhe Planin Urban të Komunës; po ashtu kryetari i komunës duhet që ta caktojë një ditë në javë për të takuar qytetarët, si dhe të publikohen në ueb-faqe konkurs për punësim si dhe kriteret.
- **Transparenca financiare:** Komuna duhet të publikoj raportet tre-mujore të shpenzimeve, raportet për ndërmarrje komunale, rajonale, të hyrat vetanake të komunës dhe si dhe listat e pronave në pronësi të komunës si dhe ato të marra me qira për Komunën.
- **Publikimi i dokumenteve për transparencë:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe planin e Prokurimit, njoftimet për kontrata dhe dhënien e kontratave, të bëjë publikimin e Raportit të Auditorit si dhe të bëhen publike në ueb-faqe.
- **Komuna e Mamushës** duhet që të mbajë raporte të rregullta nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore (KAB), si dhe ta publikojë atë në ueb-faqen zyrtare të komunës.
- **Publikimi i raporteve nga konsultimet publike:** Komuna e Mamushës po ashtu duhet të praktikojë mbajtjen e procesverbaleve nga takimet dhe konsultimet publike, të shpërndajë materiale përcjellëse, të publikojë draft-buxhetin e komunës në ueb faqen e komunës
- **Komuna e Mamushës,** duhet që të publikojë në ueb-faqën e saj edhe të dhëna të tjera të rëndësishme për komunën OPEN-DATA, të ketë një linjë direkte për brengat e qytetarëve. Të publikojë listën e hollësishme për shërbimet që ofron komuna për qytetarët e sajë.

# ANEKSET, INDIKATORËT DHE KOMENTET

## ANEKS 1: INDIKATORËT DHE PESHA E TYRE

#	KUVENDI I KOMUNES	PESHA	#	FINANCAT	PESHA
1	Qasja në rendin e ditës	1	1	Ndryshimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi i Komunës	3
2	Seancat e hapura për publikun	3	2	Borxhi publik komunal (borxh i kompanive)	2
3	Transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit	2	3	Raporti i shpenzimeve tremujore	4
4	Qasja në procesverbale	4	4	Raporti i Auditimit	2
5	Qasja në draftet e rregulloreve dhe planeve	3	5	Diskutimet brenda afateve ligjore të shpenzimeve tre-mujore në Kuvend	2
6	Qasja në rregulloret dhe vendimet	5	6	Lista e pronave (zyrat, lokalet, etj) të marra me qira për komunën	3
7	Komitetet e hapura për publikun	3	7	Të hyrat vetanake të Komunës	3
8	Mbajtja e seancave të rregullta (10 brenda vitit)	4	8	Plani buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale	5
9	Plani i punës së Kuvendit	3	9	Plani i Prokurimit	4
10	Detajet biografike dhe email-adresat e Anëtarëve të Kuvendit	3	10	Njoftimet për Kontratë dhe dhënie të Kontratës	2
11	Plani i veprimit për Transparencë	4	11	Publikimi i Kontratave	5
<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>	<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>

|||||

#	ZYRA E KRYETAR/IT/ES	PESHA	#	KONSULTIMET PUBLIKE	PESHA
1	Zyrtarë për informim & Koordinatori. Për qasje në D.Z	1	1	Njoftimi on&offline forma tradicionale, gazeta, shpallje) për takime publike	1
2	Raporti gjashtëmujor i punës	5	2	Raport nga Konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet (KAB)	3
3	Niveli i kthimit të përgjigjes për qasje n D.Z	4	3	Takimet publike të rregullta me qytetar (fshatra apo komunë)	5
4	Publikimi i planit të punës së Kryetarit	3	4	Organizimi i dëgjimeve publike dhe dëgjimet buxhetore (1 për 25,000 banorë -KAB)	5
5	Vizitat javore të Kryetarit/ës	3	5	Material përcjellës qytetarëve për dëgjimet publike dhe buxhetore (KAB)	3
6	Raporti i Kryetarit/es në Kuvend (raporti i punës 2 herë në vit)	3	6	Konsolidimi dh konsultimi i Bashkësive Lokale	3
7	Konkurs për punësim dhe kriteret ne ueb faqe	3	7	Linjë direkte pa pages për qytetarët	2
8	Vendimet e Kryetarit të Komunës	5	8	Hapja e të dhënave statistikore OPEN DATA	3
9	Planet Zhvillimore të Komunës	4	9	Takimet me organizata të shoqërisë civile	3
10	Detajet Biografike të Kryetarit dhe drejtorëve (email, Nr kontaktues, biografi etj)	2	10	Listën e hollësishme të shërbimeve që i ofron institucioni për publikun	4
11	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare (gjuhët në përdorim)	2	11	Rifreskimi i Faqes së Febookut	3
<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>	<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>

|||||

## ANEKS 2: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (1)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KUVENDIN E KOMUNËS	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MAMUSHË
Ueb-Faqe	Qasja në rendin e ditës	3	2	3	3	3	2
Fizikisht	Seancat e hapura për publikun	3	3	3	3	3	3
Fizikisht	Transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit	3	3	0	3	2	0
Ueb-Faqe	Qasja në procesverbale	0	3	3	0	1	0
Ueb-Faqe	Qasja në draftet e rregulloreve dhe planeve	2	2	3	3	1	0
Ueb-Faqe	Qasja në rregulloret dhe vendimet	2	3	3	3	3	1
Fizikisht	Komitetet e hapura për publikun	2	2	2	3	1	2
Fizikisht	Mbajtja e seancave të rregullta (10 brenda vitit)	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Plani i punës së Kuvendit	3	0	3	3	0	0
Ueb-Faqe	Detajet biografike dhe email-adresat e Anëtarëve të Kuvendit	1	2	2	2	1	1
Ueb-Faqe	Plani i veprimit për Transparencë	3	2	3	0	3	0

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË EKZEKUTIVIN E KOMUNËS	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MAMUSHË
Fizikisht	Zyrtarë për informim & Koordinator. Për qasje në D.Z	3	3	3	3	1	1
Ueb-Faqe	Raporti gjashtëmuor i punës	1	1	3	2	0	0
KërkesëZyrt.	Niveli i kthimit të përgjigjes për qasje n D.Z	1	3	3	2	1	2
Ueb-Faqe	Publikimi i planit të punës së Kryetarit	0	0	0	0	0	0
Fizikisht	Vizitat javore të Kryetarit/ës	0	3	3	3	0	0
Fizikisht	Raporti i Kryetarit/es në Kuvend (raporti i punës 2 herë në vit)	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Konkurs për punësim dhe kriteret ne ueb faqe	3	3	3	3	3	0
Ueb-Faqe	Vendimet e Kryetarit të Komunës	3	0	3	3	3	0
Ueb-Faqe	Planet Zhvillimore të Komunës	2	3	3	2	2	0
Ueb-Faqe	Detajet Biografike të Kryetarit dhe drejtorëve (email, Nr kontaktues, biografi etj)	2	3	2	2	2	1
Ueb-Faqe	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare (gjuhët në përdorim)	2	1	1	0	2	1



## ANEKS 3: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (2)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA FINANCIARE	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MAMUSHË
Fizikisht/KërkesëZyrt.	Ndryshimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi i Komunës	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Borxhi publik komunal (borxh i kompanive)	0	0	2	0	0	0
Ueb-Faqe	Raporti i shpenzimeve tremujore	3	3	3	3	3	0
Ueb-Faqe	Raporti i Auditimit	3	3	3	3	3	0
Fizikisht	Diskutimet brenda afateve ligjore të shpenzimeve tre-mujore në Kuvend	2	2	2	2	3	2
KërkesëZyrt/Ueb-Faqe	Lista e pronave (zyrat, lokalet, etj) të marra me qira për komunën	3	3	3	3	3	0
Ueb-Faqe	Të hyrat vetanake të Komunës	3	2	3	3	3	2
Ueb-Faqe	Plani buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale	2	2	3	2	2	0
Ueb-Faqe	Plani i Prokurimit	1	3	3	3	0	0
Ueb-Faqe.	Njoftimet për Kontratë dhe dhënie të Kontratës	3	1	1	3	3	0
KërkesëZyrt	Publikimi i Kontratave	2	3	3	3	2	3

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN	PRIZREN	SUHAREKË	RAHOVEC	MALISHEVË	DRAGASH	MAMUSHË
Fizikisht/ Ueb-Faqe	Njoftimi on&offline forma tradicionale, gazeta, shpallje) për takime publike	3	3	3	3	3	1
KërkesëZyrt/Ueb-Faqe	Raport nga Konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet (KAB)	0	1	1	1	0	0
Fizikisht/Ueb-Faqe	Takimet publike të rregullta me qytetar (fishatra apo komunë)	0	3	3	3	3	3
Fizikisht/Ueb-Faqe	Organizimi i dëgjimeve publike dhe dëgjimet buxhetore (1 për 25,000 banorë -KAB)	3	3	3	3	3	3
Fizikisht/Ueb-Faqe	Material përcjellës qytetarëve për dëgjimet publike dhe buxhetore (KAB)	2	0	2	3	2	0
Fizikisht	Konsolidimi dh konsultimi i Bashkësive Lokale	2	2	3	2	1	0
Fizikisht	Linjë direkte pa pages për qytetarët	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Hapja e të dhënave statestikore OPEN DATA	1	1	2	2	2	0
Fizikisht	Takimet me organizata të shoqërisë civile	1	1	1	2	1	1
Ueb-Faqe	Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun	1	1	1	1	1	0
Ueb-Faqe	Rifreskimi i Faqes së Febookut	2	3	0	3	0	2

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

352(496.51-2)"2016"(048)  
Transparometri komunal : Prizren, Rahovecë, Malishevë,  
Dragashë, Mamushë korrik-dhjetor, 2016 / Përgatitur nga Naim  
Cahanaj. – Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2017. – 34 f.  
: ilustr. ; 21 cm.  
1.Cahanaj, Naim  
**ISBN 978-9951-745-00-0**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:




This publication is part of the project **Civic Involvement for Transparency and Accountability**, implemented by **Kosova Democratic Institute**, financed by Olof Palme International Center supported by Swedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.





# TRANSPAROMETRI KOMUNAL



PRIZREN, SUHAREKË, RAHOVEC, MALISHEVË, DRAGASH, MAMUSHË  
KORRIK – DHJETOR 2016

SHKURT 2017, PRIZREN